



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE  
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE PLATFORMËS SË  
BASHKËQEVERISJES**

Nr.1886//3 prot.

Tiranë, më 07.04.2025

Lënda: Kthim Përgjigje

**Znj. P. Y**

**Adresa: Gramëz, Thumanë, Krujë**

Në përgjigje të kërkesës suaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar me nr. 1886/2, datë 20.03.2025, në lidhje me rishqyrtimin e pensionit të pleqërisë, ju informojmë si më poshtë:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, me vendimin nr. 4355, datë 10.01.2018, bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju ka caktuar pension pleqërie me datë fillimi 01.12.2017, në masën fillestare prej 8.157 lekë në muaj, me një periudhë sigurimi prej 19 vitesh e 3 muajsh.

Në llogaritjen e vjetërsisë suaj në punë është përfshirë periudha 01.10.1993 deri më 31.12.2012, gjatë së cilës keni qenë e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi, bazuar në deklaratën tuaj të datës 15.12.2017, ku keni specifikuar këtë periudhë sigurimi.

Me vendimin nr. 4355/1, datë 13.02.2025, pensioni juaj është rishqyrtuar, duke përfshirë periudhën shtator 1973 deri në vitin 1991, gjatë së cilës keni punuar në ish-Kooperativën Borizanë. Kjo periudhë është njohur me vendimin nr. 937, datë 30.10.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Rishqyrtimi është kryer pas aplikimit tuaj të datës 13.11.2024, ku keni dorëzuar vendimin e sipërpërmendur të gjykatës.

Pas rishqyrtimit, periudha e sigurimit rezulton të jetë 36 vjet e 5 muaj, masa fillestare e pensionit është 13.930 lekë në muaj, ndërsa masa aktuale e pensionit është 19.146 lekë në muaj. Për

periudhën 13.11.2024 deri më 28.02.2025, keni përfituar shtesën kreditore prej 28.566 lekësh, e cila ju është gjeneruar së bashku me pensionin e rishqyrtuar të muajit mars 2025.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!